



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Fondi për Kompozitorët e Rinj “Çesk Zadeja”

I. Përshkrimi i projekti

Konkursi zhvillohet në kuadër të përkujtimit dhe në nderim të figurës qendrore të fondit muzikor shqiptar, ikonës shqiptare të muzikës, kompozitori Çesk Zadeja, me rastin e 95-vjetorit të lindjes dhe 25- vjetorit të ndarjes nga jeta.

Konkursi për Kompozitorët e Rinj, synon mbështetjen e krijimtarisë shqiptare dhe promovimin e krijimtarisë muzikore në vend. Kjo edhe në kuadër të programit të parë profesional muzikor në Shqipëri “Akademia Teatrale”.

Një projekt tërësisht i ri, iniciuar në kuadër të promovimit, zhvillimit dhe perfeksionimit të teknikës në disiplinën lirike, ku të rinjtë trajnohen rreth interpretimit skenik, teknikës vokale, trajnimeve specifike të stilit dhe interpretimit të “Bel Cantos” italiane, nga emrat më të mirënjohur botërorë.

Nëpërmjet këtij konkursi do të përzgjidhen për tu interpretuar vetëm veprat e 3 çmimeve fituese, si më poshtë vijon:

1. Çmimi i Parë, “Çesk Zadeja 2023”,
2. Çmimi i dytë “70 vjetori i TKOB-së”, vepër muzikore vokale instrumentale
3. Çmimi i tretë;

Në këtë kontekst duke marrë parasysh referencat e fushës, mbi realizimin e Fondit Vjetor të Krijimtarisë Muzikore, TKOB shpall, Konkursin për Kompozitorët e Rinj “Çesk Zadeja”, (edicioni i dytë).

II. Objektivat e projektit

- Të inkurajojë krijimtarinë e re dhe krijimin e veprave muzikore origjinale nga kompozitorët e rinj në Shqipëri.
- Të promovojë talentin dhe potencialet e kompozitorëve të rinj në skenën e Teatrit të Operës dhe Baletit

- Të ndërtojmë një platformë të qëndrueshme për mbështetjen dhe zhvillimin e krijimtarisë së re në Shqipëri
- Të ndikojmë në rritjen e cilësisë artistike në Shqipëri, që të ndërtojmë një shoqëri me vlera të forta kulturore.

III. Kriteret e pjesëmarrjes

Konkursi i kompozicionit “Çesk Zadeja”, synon evidentimin dhe mbështetjen e kompozitorëve të rinj. Për të marrë pjesë në konkurs, kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e pjesëmarrjes si më poshtë vijon:

- Mund të aplikojnë kandidatët e grupmoshës 20-30 vjeç
- Kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë kompozitorët e rinj në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë e Veriut
- Krijuesit kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm me një vepër muzikore;
- Vepra e paraqitur nuk duhet të jetë interpretuar më herët (pjesërisht ose në mënyrë të plotë), apo publikuar në çfarëdo forme ose të jetë shpallur fituese në një konkurs;
- Vepra duhet të përfshijë të paktën 2 dhe jo më shumë se 5 prej instrumenteve të poshtëshënuar;
- Flaut dhe Flaut i vogël, Oboe, Korno ingleze, Klarinetë, Klarinetw e Vogwl, Bass, Fagot, Kontrofagot, Piano, Violinë, Violë, Violonçel, Kontrabas, Harpë, Kitarë, Trombë, Bastube, Trombon, Basstube, Korno;
- Kohëzgjatja e veprës duhet të jetë 5-10 minuta.

IV. Regjistrimi në Konkurs

Për tu regjistruar në konkurs kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë së Teatrit të Operës dhe Baletit, në adresën Sheshin Skënderbej.

Deri më datë **06.11.2023**, dokumentacionin si më poshtë vijon:

Një zarf i cili duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme.

- Të dërgojë në mënyrë elektronike një video prezantimi, ku prezanton veten dhe punën e tij/ saj
- Formularin e aplikimit të plotësuar (bashkëngjitur);
- Kartën e Identitetit ose pasaportë;
- Portofoli i veprimtarisë së krijuesit (CV);
- Diplomë;
- Dy fotografi të përditësuara;
- Partiturën e veprës të shkruar me një program notëzimi (Finale, Sibelius, Dorico etj);

Partitura duhet të garantojë anonimatimin e kompozitorit dhe titullit, nëse ka, të veprës. Rrjedhimisht, përveç notave muzikore dhe shënimeve të tjera shprehëse të veprës (dinamika, legjende interpretimi etj) partitura duhet të përmbajë një **Kod** (të shkruar qartësisht në faqen e parë) dhe nuk duhet të ketë asnjë shenjë tjetër (emër kompozitori, titull etj).

- Letër miratimi në rast përzgjedhjeje si vepër fituese, për interpretimin e saj në një koncert me pjesëmarrje masive të kompozitorëve shqiptar.

- Kandidatët që klasifikohen fitues, menjëherë pasi të njoftohen për rezultatet paraprake duhet të dorëzojnë partet e veprës, (të shkruar me një program notëzimi)

V. Kriteria Specifike

Thirrja për krijuesit e rinj për vitin 2023 do të pranojë aplikime për kategorinë Muzikë Instrumentale dhe Vokale e Dhomës.

VI. Kalendari

- ✓ 06 nëntor 2023-Afati i dorëzimit të veprës;
- ✓ 7- 21 nëntor - Vlerësimi dhe seleksionimi i veprave nga juria;
- ✓ Dhjetor 2023 - Dhënia e çmimeve & interpretimi në publik i veprave Fituese.

VII. Të drejtat e autorit

Të drejtat e autorit do të zbatohen në përputhje me legjislacion në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to. Në rast se vepra muzikore kualifikohet apo shpallet fituese, TKOBAP, ka të drejtën e përdorimit për vënien në skenë të veprës origjinale dhe të prejardhur që do të ekzekutohet nga trupat artistike të Institucionit/Institucioneve. Ky shfrytëzim nuk bie ndesh me shfrytëzimin normal të veprës së autorit apo mbajtësit të së drejtës. Deklaratë noteriale mbi origjinalitetin e veprës për mos adaptimin nga vepra të tjera, apo plagjiaturë.

VIII. Juria dhe përbërja e saj:

Veprat e plota do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga një juri me personalitete të fushës, shqiptarë e të huaj.

**Çmimet janë subjekt i tatimit sipas ligjit të taksave të Republikës së Shqipërisë*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

FORMULAR APLIKIMI

Emër Mbiemër	
Datëlindja	dita/ muaji/ viti
Gjinia	
Adresa, numër celulari, e-mail	
Kodi dhe Titulli i Veprës (nëse ka)	
Kohëzgjatja	
Përbërja instrumentale	
E Drejta e Autorit	Unë i nënshkruari.....lindur më.....me dokument identifikimi nr.....deklaroj me përgjegjësi se në rast përzgjedhjeje i jap të drejtën organizatorëve të sigurojnë interpretimin e veprës së dorëzuar pa pretenduar shpërblim financiar.

Unë i nënshkruari.....pranoj të gjitha kushtet e parashikuara nga konkursi i kompozicionit organizuar nga TKOBAP dhe paraqes veprën time për tu vlerësuar.

Data
Nënshkrimi

Emër Mbiemër